



PSH .nr. 877/20

**PANELI SHQYRTUES**, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të Goran Milenković - Kryetar, Nuhi Paçarizi - Referues, Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: N.N.P “Elektro”-Vushtrri, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik: “NART GROUP” SH.P.K- Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Sistemi i mbarëvajtjes në punë” me numër të prokurimit: 242-19-7048-221, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)-Universiteti i Prishtinës, më datën: 23.11.2020, mori këtë:

## V E N D I M

**I. APROVOHET**, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik N.N.P “Elektro”-Vushtrri, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Sistemi i mbarëvajtjes në punë” me numër të prokurimit: 242-19-7048-221, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)-Universiteti i Prishtinës.

**II. VËRTETOHET**, njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Sistemi i mbarëvajtjes në punë” me numër të prokurimit: 242-19-7048-221, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)-Universiteti i Prishtinës.

**III.** Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

**IV.** Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

**V.** Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues N.N.P “Elektro”-Vushtrri, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI .Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues N.N.P “Elektro”-Vushtrri, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 02.11.2020 me nr. 877/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Sistemi i mbarëvajtjes në punë” me numër të prokurimit: 242-19-7048-221, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)-Universiteti i Prishtinës, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 7, 59, dhe 69.4 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 02.11.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues në raportin e dt: 09.11.2020, lidhur me pretendimin ankimor të OE-ankues sqaron si në vijim:

**Sqarim hyrës:** Ky aktivitet i prokurimit ka qenë objekt shqyrtimi në OSHP dhe se Paneli shqyrtues lidhur me këtë aktivitet ka nxjerrë vendimet me numër 826/19, 28/20, 225/20 dhe 380/20.

Pretendimi ankimor i OE ankues sipas kësaj ankesë ka të bëjë me vendimin e AK-së për eliminimin e OE ankues pas rivlerësimit, bazuar në vendimin e OSHP-së të datës 380/20. Për të dhënë një pasqyrë me të qartë në lidhje me këtë ankesë dhe rrjedhën e këtij aktiviteti të prokurimit, në mënyrë kronologjike sqarojmë si vijon:

- OE “NART GROUP” SH.P.K ka parashtruar ankesë me numër 28/20 në OSHP kundër vendimit të AK-së. Me datë 26.02.2020, Paneli Shqyrtues ka vendosur në lidhje me këtë ankesë dhe aktivitetin e ka kthyer në rivlerësim, duke i jep të drejtë të drejtë OE “NART GROUP” SH.P.K lidhur me pretendimet për eliminimin nga AK, si dhe duke e konstatuar se OE “Elektro” N.N.P nuk ka dorëzuar sigurimin e tenderit sikurse është kërkuar në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë, rrjedhimisht sipas vendimit të Panelit Shqyrtues të OSHP-së konstatohet se oferta OE “Elektro” N.N.P është dashur të refuzohet nga AK.



- OE “Elektro” N.N.P ka parashtruar ankesë me numër 225/20 në OSHP kundër vendimit të AK-së. Me datë 08.05.2020 Paneli Shqyrtues ka vendosur në lidhje me këtë ankesë dhe ka anuluar këtë aktivitet të prokurimit. Në lidhje me pretendimin e OE “Elektro” N.N.P për arsyen e eliminimit që lidhet me sigurimin e tenderit, paneli shqyrtues e ka rikonfirmuar përgjigjen e dhënë në vendimin 28/20 të datës 26.02.2020. Ndërsa për pretendimet tjera që lidhen me ofertën e OE “NART GROUP” SH.P.K i ka cilësuar si të pabazuara, përjashtuar pretendimit për vazhdimin e vlefshmërisë dhe sigurimit të tenderit, e për të cilin Paneli Shqyrtues e ka cilësuar si të bazuar.
- OE “NART GROUP” SH.P.K ka parashtruar ankesë me numër 380/20 në OSHP kundër vendimit të AK-së për anulimin e aktivitetit të prokurimit. Me datë 07.08.2020, Paneli Shqyrtues ka vendosur në lidhje me këtë ankesë dhe aktivitetin e ka kthyer në rivlerësim, duke i jep të drejtë të drejtë OE “NART GROUP” SH.P.K lidhur me pretendimet për vlefshmërinë dhe sigurimin e tenderit, marrë për bazë faktin se zyrtari i Prokurimit pranë AK-së nuk kishte caktuar afat të dorëzimit të vazhdimin të vlefshmërisë dhe sigurimit të tenderit.

**Përgjigje në Pretendimin Ankimor:** OE ankues pretendon se AK ka bërë shkelje duke eliminuar OE ankues për sigurimin e tenderit, përkundër që AK kishte kërkuar zgjatjen e afatit të sigurimit.

Fillimisht, sqarojmë se ky pretendim ishte trajtuar në ankesat me numër 28/20 dhe 225/20, dhe Paneli Shqyrtues në të dy rastet ka vendosur duke e konstatuar se mosdorëzimi i sigurimit sikurse është kërkuar në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit e ka bërë të papërgjegjshme ofertën e OE “Elektro” N.N.P dhe AK është dashur ta refuzoj tenderin. Megjithatë, AK përmes emailit të datës 19.04.2020, përsëri e kërkon vazhdimin e vlefshmërisë dhe sigurimit të tenderit për OE të cilët kanë dorëzuar oferta, përfshirë OE ankues, përkundër që i njëjti nuk kishte dorëzuar sigurimin së bashku me ofertën. Në këtë mënyrë, AK risjellë konfuzion tek OE ankues, në lidhje me këtë aktivitet.

Megjithatë, përkundër kësaj eksperti shqyrtues konsiderojnë se në thelb ky pretendim ankimor është trajtuar në dy vendimet e Panelit Shqyrtues dhe ri-shqyrtimi i pretendimit të njëjtë ankimor është në kundërshtim me Rregulloren e Punës së OSHP-së 01/2017, përkatësisht nenin 16, paragrafi 2. Në të njëjtën kohë e njofton Panelin Shqyrtues se ky pretendim është trajtuar, e për të cilin është vendosur sipas vendimeve 28/20 dhe 225/20.

Si përfundim, i rekomandojmë Panelit Shqyrtues që ankesa të aprovohet si pjesërisht e bazuar për faktin se OE ankues ka pranuar kërkesë nga AK për zgjatjen e sigurimit dhe në të njëjtën kohë ka dorëzuar sigurimin. Megjithatë ashtu sikurse është sqaruar mësipër, fakti që nuk e ka dorëzuar sigurimin së bashku me ofertën e bën ofertues të papërgjegjshëm.

**Mendimi i ekspertit shqyrtues:** Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK-së.

Autoriteti Kontraktues, Nuk ka përgjigje

Operatori Ekonomik, Nuk ka përgjigje

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 23.11.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se ky aktivitet i prokurimit ka qenë objekt shqyrtimi në OSHP dhe janë nxjerrë vendimet me numër PSH.nr.826/19, PSH.nr.28/20, PSH.nr. 225/20 dhe 380/20. Pretendimi ankimor i OE ankues sipas kësaj ankesë ka të bëjë me vendimin e AK-së për eliminimin e OE ankues pas rivlerësimit, bazuar në vendimin e OSHP-së të datës 380/20. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron rrjedhën e këtij aktiviteti të prokurimit, në mënyrë kronologjike si vijon:

- OE “NART GROUP” SH.P.K ka parashtuar ankesë me numër 28/20 në OSHP kundër vendimit të AK-së. Me datë 26.02.2020, Paneli Shqyrtues ka vendosur në lidhje me këtë ankesë dhe aktivitetin e ka kthyer në rivlerësim, duke i jep të drejtë të drejtë OE “NART GROUP” SH.P.K lidhur me pretendimet për eliminimin nga AK, si dhe duke e konstatuar se OE “Elektro” N.N.P nuk ka dorëzuar sigurimin e tenderit sikurse është kërkuar në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë, rrjedhimisht sipas vendimit të Panelit Shqyrtues të OSHP-së konstatohet se oferta OE “Elektro” N.N.P është dashur të refuzohet nga AK.
- OE “Elektro” N.N.P ka parashtuar ankesë me numër 225/20 në OSHP kundër vendimit të AK-së. Me datë 08.05.2020 Paneli Shqyrtues ka vendosur në lidhje me këtë ankesë dhe ka anuluar këtë aktivitet të prokurimit. Në lidhje me pretendimin e OE “Elektro” N.N.P për arsyen e eliminimit që lidhet me sigurimin e tenderit, paneli shqyrtues e ka rikonfirmuar përgjigjen e dhënë në vendimin 28/20 të datës 26.02.2020. Ndërsa për pretendimet tjera që lidhen me ofertën e OE “NART GROUP” SH.P.K i ka cilësuar si të pabazuara, përjashtuar pretendimit për vazhdimin e vlefshmërisë dhe sigurimit të tenderit, e për të cilin Paneli Shqyrtues e ka cilësuar si të bazuar.



- OE "NART GROUP" SH.P.K ka parashtuar ankesë me numër 380/20 në OSHP kundër vendimit të AK-së për anulimin e aktivitetit të prokurimit. Me datë 07.08.2020, Paneli Shqyrtues ka vendosur në lidhje me këtë ankesë dhe aktivitetin e ka kthyer në rivlerësim, duke i jep të drejtë të drejtë OE "NART GROUP" SH.P.K lidhur me pretendimet për vlefshmërinë dhe sigurimin e tenderit, marrë për bazë faktin se zyrtari i Prokurimit pranë AK-së nuk kishte caktuar afat të dorëzimit të vazhdimit të vlefshmërisë dhe sigurimit të tenderit.

Lidhur me pretendimin ankimor se AK ka bërë shkelje duke eliminuar OE ankues për sigurimin e tenderit, përkundër që AK kishte kërkuar zgjatjen e afatit të sigurimit. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se ky pretendim ishte trajtuar në ankesat me numër 28/20 dhe 225/20, dhe Paneli Shqyrtues në të dy rastet ka vendosur duke e konstatuar se mosdorëzimi i sigurimit sikurse është kërkuar në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit e ka bërë të papërgjegjshme ofertën e OE "Elektro" N.N.P dhe AK është dashur ta refuzoj tenderin. Megjithatë, AK përmes emailit të datës 19.04.2020, përsëri e kërkon vazhdimin e vlefshmërisë dhe sigurimit të tenderit për OE të cilët kanë dorëzuar oferta, përfshirë OE ankues, përkundër që i njëjti nuk kishte dorëzuar sigurimin së bashku me ofertën. Në këtë mënyrë, AK risjellë konfuzion tek OE ankues, në lidhje me këtë aktivitet. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron ky pretendim ankimor është trajtuar në dy vendimet e Panelit Shqyrtues dhe ri-shqyrtimi i pretendimit të njëjtë ankimor është në kundërshtim me Rregulloren e Punës së OSHP-së 01/2017, përkatësisht nenin 16, paragrafi 2. Andaj, ky pretendim është trajtuar, dhe për të është vendosur sipas vendimeve 28/20 dhe 225/20.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron vlerëson që ankesa të aprovohet si pjesërisht e bazuar për faktin se OE ankues ka pranuar kërkesë nga AK për zgjatjen e sigurimit dhe në të njëjtën kohë ka dorëzuar sigurimin. Megjithatë ashtu sikurse është sqaruar mësipër, fakti që nuk e ka dorëzuar sigurimin së bashku me ofertën e bën ofertues të papërgjegjshëm.

Paneli Shqyrtues në bazë të shkresave të lëndës dhe ecurinë e këtij aktiviteti të prokurimit, vjen në përfundim se autoriteti kontraktues ka bërë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve në harmoni me nenin 59 të LPP-së. Gjithashtu, duke pasur parasysh se OE ankues nuk e ka dorëzuar sigurimin së bashku me ofertën e bën ofertues të papërgjegjshëm. Gjithashtu, paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues ka pasur në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.



**Vendimi t'i dorëzohet:**

1x1 AK- Universiteti i Prishtinës

1x1 OE - "Elektro" N.N.P - Vushtrri

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.